



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Tiranë, më datë 01.07.2020

Nr. 674 Prot.

VENDIM

Nr. 152, datë 04.06.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, neni 48 dhe neni 134, pika 1, dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të projekteve të zbatimit, të konsolidimit dhe konservimit, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 04.06.2020,

VENDOSI:

1. Mos miratimin e projektit të ndryshuar “4 godina banimi, 5 kat me 1 kat parkimi nëntokë”, Rr. “Anastas Durraku”, Durrës, zona arkeologjike B, kërkesë e shoqërisë “Jedas” sh.p.k - të ndryshohet njolla e objektit duke lënë jashtë saj varret e zbuluara.
2. Miratimin e projektit konsolidimi dhe konservimi për “Gjetjet arkeologjike, (varret në gropën Nr. 1) hartuar nga shoqëria “K.A.E.XH.” sh.p.k.;
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

